



Planuar / Doretuar Punigjend/Produato Kryesuesit/Deliverty	28 - 06 2021	1	viti god year
Organ/Njësia Organ /jednica Org /Unit	Hi Prot Hi Prot Prot No	Shtojta Prilog Appendix	Sasia Kolicana Quantity
SKANBICK	3327/2021		1/3



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr. 498/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës - Kolegji për shqyrtimin e ankesave i përbërë nga: Arben Mehmeti kryetar, Ardita Haxhnikaj Demi dhe Eshref Shabani, anëtarë, si dhe Çlirim Zeka, Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit për shqyrtimin e ankesës A.nr.733/2019, të datës 25.11.2019, të ankuesit

sipas aktgjykimit A.nr.55/2020, sipas Aktgjykimit të datës 25.05.2021, të Gjykatës Themelore në Prishtinë Departamenti për Çështje Administrative, me adresë banimi rruga „Xhevat Berisha“, numër 50 nga Komuna e Prizrenit, kundër organit të punësimit Komuna e Prizrenit, në çështjen juridike “ Kontestim Konkursi”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1.1 nen paragrafin 1.1, nenin 16 dhe nenin 18 paragrafin 1 nen paragrafin 1.8 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës në seancën për këshillim dhe votim me datë 28.06.2021, mori këtë;

V E N D I M

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, shpallet jo kompetent për të vendosur lidhur me ankesën A.nr.733/2019, të datës 25.11.2019, të ankuesit

A r s y e t i m

Ankuesi me datë 25.11.2019, me numër protokoli 5513/20219, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 09.01.2020, me numër protokoli 45/2021, ka njoftuar ankuesin se Këshilli nuk është kompetent për ta shqyrtuar ankesën e ankuesit.

Gjykata Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative, me datë 02.06.2021, me numër A.nr. 55/2020, ka nxjerr Aktgjykim me të cilin ka aprovuar kërkesë padinë e paditësit, dhe ka ankuar njoftimin e Këshillit të datës 09.01.2020, duke e detyruar që në afatin prej tridhjetë (30) ditës të vendos lidhur me aneksen e ankuesit të datës 25.11.2019.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova: Ankesën me Nr.Prot:5513/2019 të datës 25.11.2019 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Ankesa A.Nr.733/2019, të datës 25.11.2019, të ankuesit sipas dhe ankesës An. Nr, 498/2021, sipas Aktgjykimit të datës 02.06.2021, të Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative; Formulari për kërkesë apo ankesë i datës 13.05.2019; Njoftim i datës 09.01.2020; Akt Përcjellës i datës 09.01.2020; Kërkesë për përgjigje në ankesë e datës 03.12.2019; Ankesë për drejtorin e arsimit e datës 13.05.2019; Diplomë me nr. prot. 198/5 i datës 26.05.2002; Pliko me nr. R8682846 e datës 10.01.2021; Pliko me nr. R8682847 e datës 10.01.2020; E-mail nga I.G. për C.Z. i datës 24.10.2019; E-mail nga I.G. për C.Z. i datës 11.06.2021; E-mail nga C.Z. për I.G. i datës 10.06.2021; Konkurs për plotësimin e vendeve të lira të punës në kohë të pacaktuar me nr. 795/19 i datës 26.03.2019;

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, ka konstatuar se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nuk është kompetent për të vendosur lidhur me ankesën e ankuesit

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka analizuar Aktgjykimin, me numër A.nr. 55/2020 të datë 02.06.2021, të Gjykatës Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative, me të cilin Aktgjykim ka aprovuar kërkesë padinë e paditësit, duke e anuluar njoftimin e datës 09.01.2020, të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe duke e detyruar Këshillin të vendos lidhur me ankesën e ankuesit të datës 25.11.2019, të ankuesit

Ndërlidhur me pretendimet ankimore të ankuesit, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave pasi që ka analizuar ankesën e ankuesit në bazë të shkresave të lëndës del se ankuesi në bazë të ankesës së datës 25.11.2019 ka aplikuar për pozitën "Punëtor Teknik" në Konkursin me nr. 795/19 të datës 26.03.2019, të publikuar nga Drejtoria Komunale e Arsimit në Komunën e Prizrenit, Kolegji për shqyrtimin e ankesave ka konstatuar se pretendimet ankimore të ankuesit nuk janë të bazuara sepse ankuesi nuk ka pasur statusin e aplikuesit në shërbimin civil të Kosovës.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave , për vendosjen e kësaj çështjeje, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga ankuesi, ka konstatuar se nuk është kompetent për shqyrtimin e kësaj çështjeje, pasi që ankuesi nuk ka status të nëpunësit civil në bazë të nenit 4 paragrafi 4 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, i cili përcakton se: „*Personeli i punësuar nga institucionet e administratës në nivel qendror dhe komunal, përgjegjës për kryerjen e funksioneve mbështetëse dhe të mirëmbajtjes, nuk janë nëpunës civil*“, sepse marrëdhënia e tyre e punës nuk i nënshtrohet dispozitave të legjislacionit për shërbimin civil, por lidhet në pajtim me nenin 4 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, i cili përcakton se: “.....*Marrëdhënia e tyre e punës rregullohet me Ligjin e Punës, ligje të veçanta, me marrëveshje kolektive ose me rregullore sektoriale*“.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, po ashtu ka marrë parasysh edhe Qarkoren Administrative Nr. 01/2014, datës 08.12.2014 të lëshuar nga Ministria e Administratës Publike, e cila ka definuar listën e të punësuarve në Institucionet e Republikës së Kosovës të cilët janë



përfunduar nga shërbimi civil, në bazë të nenit 4 paragrafi 4 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, ku prej pozitive të përfunduar është edhe pozita e ankuesit.

Ndërlidhur me pretendimet ankimore të ankuesit, kolegji konstaton se Këshilli nuk është kompetent për ta shqyrtuar ankesën në pajtim me nenin 16, paragrafi 1 Ligji nr. 06/1-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për shërbimin civil të Kosovës, ku përcaktohet se: **1. Nëpunësi civil, apo kandidati për pranim në shërbimin civil i cili është i pakënaqur me vendimi e organit të punësimit, ka të drejtë të parashtojë ankesë në Këshill, lidhur me pretendimin për shkëlqen e rregullave dhe parimeve të legjislacionit për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, sepse ankuesi nuk ka status të aplikantit në Shërbimin Civil.**

Në bazë të lartcekurave dhe bazuar në nenin 6 paragrafin 1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ku përcaktohet se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës është kompetent për të shqyrtuar vetëm ankesat e nëpunësve civil dhe kandidatëve për pranim në Shërbimin Civil si dhe duke marr parasysh konstatimin se pretendimet ankimore të ankuesit i referohen periudhës gjatë të cilës ankuesi nuk kanë pasur statusin e nëpunësit civil, atëherë Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, konstaton se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës nuk është kompetent për të vendosur lidhur me pretendimet ankimore të ankuesit sipas ankesës A.nr.733/2019 të datës 25.11.2019 të parashtruar nga ankuesi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës dhe provave të ofruara nga palët, bazës ligjore të aplikuar në lidhje me këtë çështje administrative si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi.

Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës
Lënda, A.nr.498/2021, datë 28/06/2021

Çlirim Zeka

Procesmbajtës

Arben MEHMETI

Kryetar i Kolegjit



Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit .
- Kryetarit të Komunës së Prizrenit;
- Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Prizrenit;
- Arkivit të KPMSHCK-së

